EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5721
E shtunë, 9 mars 2019
çmimi 0.40 €

Ministri Ismaili: Çmime të njëjta për barnat në secilën barnatore

FAQE 6

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM REKA FAQE 4-5

SYNOJ RIKTHIMIN E BESIMIT NË SHTET

Kandidati i pavarur shqiptar për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka, ka bërë me dije se arsyeja intelektuale dhe kombëtare e ka shtyrë t'i hyjë garës për president në zgjedhjet e 21 prillit. Ai e ka quajtur sfidë garën për president për faktin se ka përballë dy kandidatë fuqimisht të përkrahur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka thënë se kthimi i rendit republikan dhe depersonalizimi i shtetit është synimi kryesor i mandatit të tij presidencial. Pavarësisht prej vështirësive, ai është zotuar se do ta jetësojë vizionin për një republikë shumetnike dhe euroatlantike. Reka ka thënë se qytetarët e Maqedonisë së Veriut duhet ta votojnë atë më 21 prill meqë synon rikthimin e besimit në shtet. Sipas tij, vota e tyre do të jetë votë për parandalimin e shndërrimit të Maqedonisë së Veriut në shtet të zbrazët

RAMA: USHTRIA KA PLAN BILATERAL ME TË GJITHA SHTETET PARTNERE

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se ushtria e Kosovës tani ka ndërtuar plan bilateral me të gjitha shtetet partnere. Të premten, gjatë raportimit para Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ai ka deklaruar se kjo forcë vazhdon të ketë raporte të shkëlqyeshme me ShBA-në dhe partnerët e tjerë, anëtarë të NATO-s FAQE 3

'Trepça' regjistrohet shoqëri aksionare

FAQE 3

AKTUALE

NË KOSOVË FESTOHET 8 MARSI F. 7

SUBJEKTET POLITIKE SHQYRTOJNË MUNDËSITË PËR EMËRIME TË GRAVE NË POZITA UDHËHEQËSE F. 7

KOCIJANÇIQI: TAKSA DUHET TË HIQET F. 3

EKONOMI

MURTEZAJ DHE QALAJ, TË PAKOMPROMIS NË LUFTIMIN E EKONOMISË JOFORMALE F. 8

ODA AMERIKANE KËRKON QË EMËRIMET NË POZITA TË LARTA PUBLIKE TË BAZOHEN NË PROFESIONALIZËM F. 8

KULTURË

NË PRIZREN HAPET EKSPOZITA 'HASJANIA' F. 10

SPORT

ISLAMI: NDAJ GJILANIT IU RIKTHEHEMI FITOREVE F. 14

DERBI PRISHTINA - RAHOVECI F. 15

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Cakaj: Shqiptarët në Mal të Zi, një urë e fortë lidhëse mes dy vendeve

PODGORICË, 8 MARS- Në kuadër të vizitës që po zhvillon në Malin e Zi, ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj u takua të premten me presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviq.

"Shqipëria vlerëson kontributin e presidentit Gjukanoviq në rrugëtimin euro-atlantik të Malit të Zi, çka njëkohësisht përfaqëson edhe kontribut për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Vizita në Podgoricë është moment i rëndësishëm për të dhenë një mesazh të përbashkët për domosdoshmërinë e nisjes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut", tha ministri Cakaj.

Kryediplomati shqiptar vlerësoi arritjet në rrafshin e bashkëpunimit dypalësh me Malin e Zi si një model për forcimin e ndërveprimit rajonal, dhe u ndal mbi rolin thelbësor të shqiptarëve në vendin fqinj, duke i konsideruar ata si përcaktues në përparimin euro-atlantik të Malit të Zi.

Theks të veçantë gjatë vizitës së tij ministri në detyrë Cakaj vuri edhe në thellimin e marrëdhënieve tregtare të cilat do të kenë një vëmendje të posaçme në mbledhjen e ardhshme të dy qeverive, sikundër dhe zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të zhvillimit ekonomik të brezit ndërkufitar.

Gent Cakaj u takua edhe me nënkryetarin e Kuvendit të Malit të Zi, Genci Nimanbegu ku u vlerësuan marrëdhëniet ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë si marrëdhënie të shkëlqyeshme, pa çështje të hapura, por gjithmonë me mundësi të përmirësimit.

Hale: Kosova dhe Serbia t'i vazhdojnë bisedimet për normalizim marrëdhëniesh

Zëvendës sekretari amerikan i Shtetit, David Hale, pas takimit në Beograd me presidentin serb Aleksandar Vuçiq, u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ndërpresin provokimet dhe t'i rihapin bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre



BEOGRAD, 8 MARS - Zëvendës sekretari amerikan i Shtetit, David Hale, u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ndërpresin provokimet dhe t'i rihapin bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre.

Hale takoi të premten në Beograd presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të diskutuar rrugët e vazhdimit të bisedimeve që janë pezulluar për shkak të refuzimit të Serbisë për vazhdimin e tyre pa heqjen e tarifave ndaj mallrave serbe që u vendosën në nëntor të vitit të kaluar nga Qeveria e Kosovës.

Në një njoftim të Ambasadës amerikane në Beograd pas takimit thuhet se "Shtetet e Bashkuara bëjnë thirrje për heqjen e tarifave, ndërprerjen e provokimeve të dyanshme dhe vazhdimin e bisedimeve. Shtetet e Bashkuara vlerësojnë partneritetin me Serbinë dhe dëshirojnë të ndërtojnë marrëdhënieve edhe më të fuqishme", thuhet në një njoftim të publikuar në rrjetin twitter.

Ndërkaq, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiqi, tha se Serbia "në një afat relativisht të shkurtër kohor do të marrë masa përmes të cilave do të reagojë ndaj mospërmbushjes së detyrimeve të Kosovës ndaj marrëveshjeve të Brukselit, vendosjes së tarifave ndaj mallrave serbe dhe ndërprerjes së bisedimeve nga ana e Prishtinës".

Presidenti serb tha se qëndrimi i Beogradit kundrejt situatës do të jetë i vendosur, serioz dhe i përgjegjshëm.

Presidenti Vuçiq, mblodhi të premten në mëngjes Këshillin e Sigurisë pas miratimit të platformës për bisedime me Serbinë nga Parlamenti i Kosovës, që përcakton vijat e kuqe të bisedimeve. Ai i tha më pas diplomatit amerikan se platforma e Prishtinës "në thelb paraqet vendimin e saj për t'u dhënë fund bisedimeve me Beogradin".

Hale pritet të qëndrojë sot (e shtunë) në Prishtinë, për t'u bërë thirrje autoriteteve që t'i pezullojnë tarifat ndaj mallrave serbe dhe të hapin rrugën për rifillimin e bisedimeve.

Në prag të vizitës në Serbi dhe Kosovë, ai u tha medieve serbe se nuk u takon Shteteve të Bashkuara që të "diktojnë përfundimin e bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit" dhe se "ka mundësi që gjatë këtij viti të arrihet një marrëveshje, nëse fillojnë bisedimet".

Javën që lamë pas, dy zyrtarë të lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë, qëndruan për dy ditë në Kosovë për të siguruar pezullimin e tarifave ndërsa paralajmëruan shtimin masave ndëshkuese nëse Kosova vazhdon të refuzojë kërkesat e tilla.

Kërkesat amerikane kanë nxitur përplasje të brendshme në Kosovë ndërmjet atyre që ngulin këmbë të dëgjohen këshillat amerikane dhe atyre që pohojnë se tarifat duhet të pezullohen vetëm me garanci për përfundimin e bisedimeve me Serbinë me njohje të ndërsjellë.

Menduh Thaçi dënohet me tre vjet burgim

Shkup, 8 mars - Gjykata Penale në Shkup i caktoi të premten dënimin me burg Menduh Thaçit, kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare dhe pesë ish-anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe ish-zyrtarë të lartë shtetërorë, për shkak të rolit të tyre në parregullsitë e procesit të zgjedhjeve vendore në vitin 2013. Thaçit iu caktua dënimi me 3 vjet e dy muaj burgim. Bedredin Ibrahimit, po ashtu zyrtar i lartë i PDSH-së dhe ish-anëtar i KSHZ-së, 4 vjet e gjashtë muaj burgim. Ish-anëtarëve të tjerë të KSHZ-së, Aneta Stefanovës, 3 vjet burgim, Vllatko Sajkovskit, 3 vjet burgim, Sasho Sërcevit, 3 vjet burgim. Edhe ish-drejtorit të shërbimit sekret, Sasho Mijallkov, 3 vjet burgim. Ky i fundit, në bazë të bisedave të përgjuara telefonike, i kishte kërkuar kryetarit të PDSH-së, Thaçi që të ndërhynte te Bedredin Ibrahimi për të votuar prishjen e procesit të votimit në komunën e Strumicës, në juglindje të Maqedonisë së Veriut. Mijallkovi u dënua për veprën "përfitim të shpërblimit përmes ndikimit të paligjshëm".

Prokurorja e Prokurorisë së Posaçme, Fatime Fetai kërkoi masën e paraburgimit për Mijallkov dhe Ibrahimi deri në hyrjen në fuqi të dënimit, për shkak të mundësisë së arratisjes së tyre, sipas saj. Nga të gjithë të akuzuarit, vetëm Menduh Thaçi nuk ishte i pranishëm në gjykatë.

Të dënuarit mund të paraqesin ankesat e tyre te Gjykata e Lartë në lidhje me masat e dënimit ndaj tyre brenda një afati të caktuar.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka raportuar në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Rama: Ushtria ka plan bilateral me të gjitha shtetet partnere

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se ushtria e Kosovës tani ka ndërtuar plan bilateral me të gjitha shtetet partnere. Të premten, gjatë raportimit para Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ai ka deklaruar se kjo forcë vazhdon të ketë raporte të shkëlqyeshme me ShBA-në dhe partnerët e tjerë anëtarë të NATO-s

EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtinë, 8 mars - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka bërë me dije se ushtria e Kosovës vazhdon të ketë raporte të mira me ShBA-në dhe anëtarët e tjerë të NATO-s. Teksa ka shpalosur në detaje punën dhe aktivitetet e FSK-së përgjatë vitit të kaluar, para Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ai ka thënë se tani kjo forcë ka ndërtuar plan bilateral me të gjitha shtetet partnere. Ai ka treguar se vetëm me ShBA-në, ushtria e Kosovës ka pasur mbi 120 aktivitete të përbashkëta. "Sidomos me ShBA-në e kemi arritur bashkëpunimin në zhvillim profesional dhe pajisje. Kemi pasur program me mbi 120 aktivitete të përbashkëta me ShBA-në dhe tash e kemi ndërtuar planin bilateral me të gjitha shtetet. Duke u bazuar në blerjen e pajisjeve, e kemi ditur që një ditë do të ndodhë tranzicioni dhe u kemi paraprirë disa projekteve", ka thënë Rama.

Komandanti i FSK-së ka treguar se kjo forcë vazhdon të ketë raporte të mira edhe me KFOR-in. "Bashkëpunimin që kemi me KFOR-in brenda ministrisë është i jashtëzakonshëm dhe varësisht nga nevojat tona, angazhojmë ekipe dhe na kanë ndihmuar që gjithçka që kemi ndërtuar, kemi ndërtuar në standarde të NATO-s", është shprehur Rama. Ai ka vlerësuar se prioriteti kryesor i kësaj force gjatë viti të kaluar ka qenë transparenca me partnerët rreth procesit të tranzicionit. "Prioritet për vitin 2018 për FSK-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes ka qenë faza e tranzicionit. Në bashkëpunim me partnerët kemi marrë një kampanjë informuese në kryeqytetet e Evropës dhe botës. Qëllimi kryesor ka qenë të jemi transparentë dhe t'i informojmë partnerët me planet tona. Ka pasur keqkuptime në raste të caktuara nga partnerët tanë", ka thënë ai.

Kurse për vitin 2019, Rama ka thënë se ushtria e Kosovës ka objektiva të tjera. Gjatë raportimit të tij, komandanti i FSK-së ka sqaruar se këtë vit duhet të ndryshohen shumë rregullore dhe të ngrehën kapacitete ekzistuese. Ai ka thënë se prioritet i FSK-së mbetet edhe zgjerimi i partneritetit. "Prioritet është rritja e zhvillimit profesional. Qëllimi është të krijojmë kapacitete trajnuese dhe zgjerim të partneritetit me partnerët tanë. Jemi në fazën e zgjerimit të partneritetit. Kemi dy atashe ushtarakë, një në Paris e tjetrin në Romë", ka deklaruar ai.

Para deputetëve, Rama ka shpjeguar edhe fazën e re të rekrutimit të ushtarëve të rinj të FSK-së. "E kemi kampanjën e rekrutimit për këtë vit. Kemi mbi 7 000 aplikantë për ushtarë të rinj. Jemi në proces të seleksionimit. Diku mbi 600 të rinj. Faza e parë apo gjysma e tyre do të fillojnë këtë vit, më 1 gusht. Bazuar në planin që kemi bërë, edhe 300 të tjerë duhet të jenë në vitin 2020", ka theksuar ai.

Rama ka pranuar se pas presionit nga Serbia, mbi 70 pjesëtarë të FSK-së janë larguar nga kjo forcë, por ka shtuar se FSK-ja vazhdon të jetë shumetnike. Sipas tij, kjo dhe shumë argumente të tjera bëjnë që FSK-ja vazhdon të mbetet institucioni më i besueshëm te qytetarët e Kosovës.

Kocijançiqi: Taksa duhet të hiqet

Prishtinë, 8 mars - Bashkimi Evropian vlerëson se platforma për bisedime me Serbinë, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, paraqet "pozicionin vetëm të njërës palë", ka thënë Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Bashkimit Evropian. "Bashkimi Evropian, si ndërmjetës, nuk komenton pozicionet individuale të palëve në dialog, por është më se e qartë se vetëm përmes dialogut mund të arrihet një marrëveshje përfundimtare", ka thënë Kocijançiq. Ajo ka paralajmëruar Prishtinën se pa anulimin e tarifës ndaj mallrave serbe nuk mund të ketë klimë për ta vazhduar dialogun. "Tarifa duhet të hiqet, dialogu është e vetmja rrugë përpara", ka thënë Kocijançiq.

Zëdhënësja e BE-së ka pohuar se është në përgjegjësi të shteteve anëtare çështja e njohjes së mundshme të Kosovës dhe se BE-ja po përpiqet për një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme për një normalizim të plotë të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që njëherësh do t'i zgjidhte të gjitha çështjet e hapura ndërmjet dy vendeve. Kuvendi i Kosovës në seancën e jashtëzakonshme ka miratuar të enjten në leximin e dytë Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Ky ligj u miratua me 58 vota për dhe tri abstenime. Në tentimin e parë për votim në seancën e re, Platforma për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht

të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, nuk mori votat e mjaftueshme, por në votimin e dytë ajo mori 61 vota për.

Flet për "Epokën e re", Blerim Reka

Synoj rikthimin e

Kandidati i pavarur shqiptar për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka, ka bërë me dije se arsyeja intelektuale dhe kombëtare e ka shtyrë t'i hyjë garës për president në zgjedhjet e 21 prillit. Ai e ka quajtur sfidë garën për president për faktin se ka përballë dy kandidatë fuqimisht të përkrahur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka thënë se kthimi i rendit republikan dhe depersonalizimi i shtetit është synimi kryesor i mandatit të tij presidencial. Pavarësisht prej vështirësive, ai është zotuar se do ta jetësojë vizionin për një republikë shumetnike dhe euroatlantike. Reka ka thënë se qytetarët e Maqedonisë së Veriut duhet ta votojnë atë më 21 prill meqë synon rikthimin e besimit në shtet. Sipas tij, vota e tyre do të jetë votë për parandalimin e shndërrimit të Maqedonisë së Veriut në shtet të zbrazët

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 8 MARS - Kandidati i pavarur për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut profesori Blerim Reka, e ka quajtur sfiduese garën zgjedhor për president. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se arsyeja kombëtare dhe ajo intelektuale e kanë shtyrë të kandidojë për të parin e vendit. "Vetë fakti se kam përballë dy kandidatë fuqimisht të përkrahur, njeri me mbështetje të koalicionit qeverisës prej 31 partish politike, tjetra kandidate e partisë më të madhe opozitare, është sfidues. Kjo ishte sfidë jo vetëm për mua e për dy partitë mbështetëse të kandidaturës sime, por për tërë elektoratin shqiptar. Edhe pse kandidat i pavarur, me mbështetjen e vetëm dy partive opozitare shqiptare, Aleancës për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa,

besimit në shtet

elektorati këtë herë do të dijë të përcaktohet se kujt duhet t'i japë votën", ka deklaruar Reka. Pavarësisht prej vështirësive, ai është zotuar se do ta jetësojë vizionin për një republikë shumetnike dhe euroatlantike. Reka ka thënë se kthimi i rendit republikan dhe depersonalizimi i shtetit është synimi kryesor i mandatit të tij presidencial. Ai ka vlerësuar se qytetarët e Maqedonisë së Veriut duhet ta votojnë atë më 21 prill meqë synon rikthimin e besimit në shtet. Sipas Rekës, vota e tyre do të jetë votë për parandalimin e shndërrimit të Maqedonisë së Veriut në shtet të zbrazët. "Sepse synoj rikthimin e besimit të humbur në shtetin dhe heqjen e depresionit të përgjithshëm që zbrazi çerekun e popullatës dhe kërcënon që në dekadën e ardhshme ta zbrazë edhe çerekun tjetër. Pra, vota e tyre do të jetë votë për parandalimin e shndërrimit të Maqedonisë së Veriut në shtet të zbrazët", ka theksuar ai, duke shtuar se kthimi i rendit republikan dhe depersonalizimi i shtetit është synimi i mandatit të tij presidencial. "Do të garoj për president të një republike shumetnike (përbrenda) dhe euroatlantike (në aspektin ndërkombëtar). Rikthimi i republikës është thelbi i programit tim politik presidencial, ngaqë republikën e vërtetë e bëjnë vetëm: sundimi i ligjit, demokracia, gjyqësori i pavarur dhe respektimi i drejtave të njeriut. Shteti nuk është pronë private, por trashëgimi e gjithë qytetarëve të saj të barabartë", është shprehur Reka.

"Epoka e re": *Z. Reka, ju keni arritur t'i mblidhni 11 000 nënshkrime të cilat e zyrtarizojnë kandidaturën tuaj për president të Maqedonisë së Veriut. Pse vendoset t'i hyni garës presidenciale të 21 prillit?*
Reka: Për të kandiduar për president vendimtare ishin dy arsye: njëra intelektuale, tjetra kombëtare. Pra, vendosa që nga kritikat virtuale t'i hyj sfidimit real politik dhe në vend të soditësit dhe kritikuesit pasiv digjital, të marr përgjegjësi për ta ndryshuar realitetin. Nga ana tjetër më dukej e papranueshme që shqiptarët të redukoheshin në një makinë elektorale që duhet dirigjuar konform diktatit partiak, pa asnjë kandidat shqiptar. Me vetëm dy kandidatë maqedonas, Republika e Maqedonisë së Veriut do të shndërrohej në një shoqëri të dy kategorive qytetarësh. Atyre që votojnë për ata që duhen votuar.

"Epoka e re": *Sa do të jetë sfiduese për ju si kandidat i pavarur ky proces zgjedhor?*
Reka: Vetë fakti se kam përballë dy kandidatë fuqimisht të përkrahur: njëri me mbështetje të koalicionit qeverisës prej 31 partish politike, tjetra kandidate e partisë më të madhe opozitare, është sfidues. Mendoj se kjo ishte sfidë jo vetëm për mua e për dy partitë mbështetëse të kandidaturës sime, por për tërë elektoratin shqiptar. Edhe pse kandidat i pavarur, me mbështetjen e vetëm dy partive opozitare shqiptare, Aleancës për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa, besoj se elektorati këtë herë do të dijë të përcaktohet se kujt duhet t'i japë votën. Nga ana ime, siç e kam thënë disa herë, nuk do të tregtoj me votat e tyre. Ato janë të shenjta dhe vetëm të tyre e jo mall tregtar të partive në pazaret politike, siç ka ndodhur në rrethin e dytë në zgjedhjet e mëparshme presidenciale në vend. Verdikti i popullit nuk është në shitje.

"Epoka e re": *Deri më tani keni marrë mbështetjen e partive shqiptare në opozitë, por jo edhe të atyre që janë pjesë e koalicionit qeverisës.*
Reka: Besoj se po e vëreni se nuk po dua të merrem me partitë që nuk guxuan të nxjerrin kandidat të vetin, por u rreshtuan përkrah kandidatit të LSDM-së. Fundja, nuk më takon mua ta komentoj vendimin e partive shqiptare që u rreshtuan pas kandidatit të pushtetit. Por, duhet thënë se janë po ato parti shqiptare që mbështetën unifikimin e faktorit politik shqiptar në Mal të Zi për fitoren për bashkinë e Tuzit, ndërkaq në Maqedoni nuk përkrahën kandidaturën e vetme shqiptare.

"Epoka e re": *Cila do të jetë platforma juaj me të cilën synoni ta merrni pozitën e presidentit?*
Reka: Do të garoj për president të një republike shumetnike (përbrenda) dhe euroatlantike (në aspektin ndërkombëtar). Rikthimi i republikës është thelbi i programit tim politik presidencial, ngaqë republikën e vërtetë e bëjnë vetëm: sundimi i ligjit, demokracia, gjyqësori i pavarur dhe respektimi i drejtave të njeriut. Sundimi i individit, ndërkaq, e zhbën republikën, duke e bërë atë shtet privat. Qeveria e mëparshme për 11 vjet e shndërroi Maqedoninë shtet të kapur, kurse presidenti aktual për 10 vjet e bëri atë shtet privat. Besuam të gjithë se shteti do të shkapet dhe do depersonalizohet, por për këta dy vjet kjo nuk ndodhi. Gjyqësori është ende politikisht i varur, Prokuroria Speciale pezull, administrata publike e nepotizuar, kriminelët e amnistuar, kurse deputetët nën hetime të imunizuar. Prandaj, kthimi i rendit republikan dhe depersonalizimi i shtetit është synimi i mandatit tim presidencial. Shteti nuk është pronë private, por trashëgimi e gjithë qytetarëve të saj të barabartë. Prandaj, Maqedonia e Veriut, si shoqëri shumetnike, duhet të jetë edhe republikë shumetnike. Më së paku, ajo mund të funksionojë me dozat e lejuara për të drejtat individuale dhe kolektive. Republika nuk njeh demokracinë e dozuar dhe as 'kombe statistikore' (20 %), të cilëve u lejohen aq të drejta sa janë në përqindje. Në republikë nuk ka 'dhënie' të drejtash, sepse ato janë të drejta të lindura si shtetas të këtij shteti, e jo 'dhuratë' diskrecioni nga pushteti që vendos se kujt, kur dhe sa të drejta do t'i lejohen. Ky synim për një republikë të njëmendtë do të jetësohej përmes pesë drejtimeve të programit tim presidencial nga: stabilizimi i marrëdhënieve ndëretnike (në politikën e brendshme) deri te politika e jashtme euroatlantike dhe e koekzistencës rajonale fqinjësore; gjitha këto si parakushte për ta kthyer perspektivën jetësore në vend dhe me të ndaljen e procesit të zbrazjes së vendit. Pra, synimet e para do të jenë në funksion të atij të fundit: parandalimit të zbrazjes së shtetit. Ndryshe, në BE para shtetit do të 'integrohen' qytetarët e ikur, kurse Republika e Maqedonisë së Veriut nga shteti anëtar do të mbetej shtet i zbrazët.

"Epoka e re": *Pse qytetarët e Maqedonisë së Veriut duhet t'ju votojnë juve për president dhe jo kandidatët e tjerë?*
Reka: Sepse synoj rikthimin e besimit të humbur në shtetin dhe heqjen e depresionit të përgjithshëm që zbrazi çerekun e popullatës dhe kërcënon që në dekadën e ardhshme ta zbrazë edhe çerekun tjetër. Pra, vota e tyre do të jetë votë për parandalimin e shndërrimit të Maqedonisë së Veriut në shtet të zbrazët.

"Epoka e re": *Z. Reka, përballë jush është kandidati i koalicionit qeveritar Stevo Pendarovski, i cili, në bazë të mbështetjes politike, ka gjasat më të mëdha për fitore. Cilat janë pritjet tuaja nga zgjedhjet e 21 prillit?*
Reka: E thash edhe më herët, unë i dua sfidat sepse vetëm sfidat sjellin ndryshime. Fakti se atë e mbështesin 31 parti politike qeveritare me mbi gjysmën e elektoratit, më motivon edhe më tepër që të shkoj deri në fund për jetësimin e vizionit tim për një republikë shumetnike dhe euroatlantike.

Ministri Ismaili: Çmime të njëjta për barna në secilën barnatore

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka organizuar të premten debat publik për udhëzimin administrativ për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se iniciativa për finalizimin e këtij dokumenti është e rëndësishme për shumë arsye, por më rëndësishmja do të jetë ruajtja e buxhetit të shtetit dhe xhepit të qytetarëve

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 8 mars - Ministria e Shëndetësisë ka organizuar debat publik për Udhëzimin Administrativ për rregullimin e çmimit të barnave dhe produkteve mjekësore. Në këtë debat i pranishëm ishte edhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili. Ministri Ismaili ka thënë se iniciativa për finalizimin e këtij dokumenti është e rëndësishme për shumë arsye, por më rëndësishmja do të jetë ruajtja e buxhetit të shtetit dhe xhepit të qytetarëve. "Çmime të njëjta për barna të njëjta në secilën barnatore, në të gjithë Kosovën, që t'u japim fund shpenzimeve shumë të larta të qytetarëve për blerjen e barnave", ka thënë ministri Ismaili.

Ismaili ka thënë se Kosova është vendi i vetëm në Evropë, së bashku me Bjellorusinë, që nuk e kanë të rregulluar blerjen e barnave me çmime referente. "Për ta ruajtur xhepin e qytetarëve, buxhetin e shtetit, dhe për ta hequr Kosovën nga kjo 'listë e zezë', në bashkëpunim të afërt me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, ne kemi hartuar Udhëzimin Administrativ për rregullimin dhe unifikimin e çmimeve të barnave", është shprehur ministri Ismaili.

Drejtori i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Kosovës, Fatmir Plakiqi, ka thënë se Fondi për Sigurim Shëndetësor aktualisht është duke punuar intensivisht për plotësimin e parakushteve të cilat janë të domosdoshme në mënyrë që të bëhet funksionalizimi i plotë dhe fillimi i rimburismit të barnave në Kosovë. "Një nga parakushtet e rëndësishme është edhe përcaktimi i çmimeve të produkteve mjekësore për të cilën gjë tashmë kemi punuar në harmoni të plotë me shumë mekanizma vendorë dhe ndërkombëtarë me ekspertë nga Banka Botërore dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë", ka thënë ai.

Arianit Jakupi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës, përmes një prezantimi tregoi mënyrën e zbatueshmërisë së këtij udhëzimi administrativ. Përmes një lidhje me 'skype' foli edhe ekspertja e OBSh-së në Danimarkë, Hanne Bak. Ajo ka thënë se janë të lumtur që po shohin përparim në reformat shëndetësore në Kosovë. "Ky është një dokument shumë i mirë që për qëllim ka t'i mbrojë qytetarët nga shpenzimet e larta financiare për blerjen e barnave", ka thënë ajo.

Udhëzimi Administrativ, pas futjes në fuqi, do t'i rregullojë çmimet e të gjitha barnave: Atyre që janë në Listën Esenciale, atyre që do të jenë të rimbursuara nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor, si dhe atyre që do të përshkruhen nga mjeku.

Haradinaj: Po punojmë që ta rrisim numrin e grave në vendimmarrje

Prishtinë, 8 mars (ER) - Në kuadër të aktiviteteve që shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Gruas në Republikën e Kosovës, kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë pjesë në konferencën "Forumi Multietnik i Lidershipit të Grave të Reja në Kosovë", që është organizuar nga Ambasada e Francës në Prishtinë në bashkëpunim me OJQ-në Kosovo Advocacy Group.

Hapjen e konferencës e kanë bërë kryeministri Ramush Haradinaj dhe ambasadori francez Didier Chabert. Në fjalën e tij, kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar faktin që kjo konferencë ka qëllimin e emancipimit të grave, nga të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë. "Qeveria ende mbetet punëdhënësja më e madhe në nivel të vendit me përfaqësim prej 40 përqindësh të grave dhe vajzave në shërbimin civil, megjithatë ne ende duhet të punojmë që ta fuqizojmë gruan dhe pozitën e tyre në shoqërinë e Kosovës, në të gjitha fushat dhe nga të gjitha komunitetet që jetojnë në vend", ka thënë kryeministri në fjalën e tij, duke theksuar faktin se "në Kosovë vlen të përmendet një nismë tejet inkurajuese që është regjistrimi i pronës së paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve. Në vitin 2016 ishin vetëm 105 raste, ndërsa deri në fund të vitit 2018, 4 100 çifte përfituan nga kjo masë afirmative".

Në fund të fjalës së tij, kryeministri ka përmendur faktin e emërimit të ministres, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Zhiviq, dhe ka shtuar se në vazhdimësi po punojmë që numri i grave udhëheqëse të jetë sa më i lartë. Ambasadori Chabert është shprehur se të gjithë duhet të angazhohemi për shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse ku femrat duhet të kenë përfaqësimin dhe të drejta të barabarta dhe të respektueshme në shoqëritë tona.

Subjektet politike shqyrtojnë mundësitë për emërime të grave në pozita udhëheqëse

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 MARS - Demokracia Plus (D+) dhe Konrad Adenauer Stiftung (KAS) të premten kanë organizuar konferencën "Jepja shansin gruas në politikë përmes pozitave udhëheqëse", me të cilin rast u prezantua edhe një publikim me të njëjtin titull. Në panel diskutues ishin zyrtarë të lartë të subjekteve politike: Sami Kurteshi (LVV), Safete Hadërgjonaj (PDK), Ahmet Isufi (AAK), Besa Baftiu (PSD), Blerta Deliu (PDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jehona Lushaku (Universiteti i Prishtinës).

Arta Sejdiu nga Demokraci Plus (D+), e cila prezantoi të dhënat nga hulumtimi, tha se partitë politike kanë mjaft mundësi për të emëruar gra në udhëheqje të ministrive, pozita udhëheqëse në Kuvend të Kosovës, drejtori komunale, struktura udhëheqëse të partive apo edhe në nominim për garë për kryetar të komunës.

Megjithatë, hulumtimi tregon se përfaqësimi i grave mbetet i ulët.

Në poste ministrore janë emëruar tri gra në mandatin e kaluar dhe dy gra në këtë mandat, edhe pse numri i ministrive kalon numrin 20. Ndërsa nga 76 zëvendësministra të identifikuar nga D+ në këtë mandat, vetëm gjashtë prej tyre ishin gra. Asnjë nga partitë politike që kanë garuar në zgjedhje nuk kanë pasur të nominuar një grua për kryeministre. Përveç kësaj, asnjë grua nuk është emëruar në postet e zëvendëskryeministres.

Hulumtimi i D+ tregon se emërimet e grave mbesin në nivel tejet të ulët në udhëheqjen e drejtorive komunale, mirëpo kryetarët e dy komunave, Qëndron Kastrati nga Kamenica dhe Ramiz Lladrovci nga Drenasi, kanë dhënë shembull të mirë duke emëruar më shumë gra se burra në drejtimin e drejtorive komunale. Vetëm dy parti në pushtet komunal kanë emëruar gra nënkryetare të komunave, ndërsa vetëm pesë kuvende komunale udhëhiqen nga gratë, përderisa 33 tjerë me burra.

Arta Sejdiu ka treguar se udhëheqja e grave me degët e partive dhe kandidimi i tyre është tejet i ulët dhe këtu duhet të kenë vëmendje më të madhe partitë politike.

Vetëm tetë degë të tri partive më të mëdha, LDK-së, LVV-së dhe PDK-së, udhëhiqen nga gra dhe po i njëjti numër i grave ishin kandiduar nga subjektet për kandidate për të parin e komunës.

Më tutje, në hulumtim u shfaqën të gjeturat mbi sfidat e grave në politikë sipas vetë grave që janë aktive në parti politike të ndryshme që i kishte intervistuar Demokracia Plus (D+).

Demokracia Plus (D+) bëri thirrje që: Ligji për Qeverinë të sigurojë përfaqësim gjinor më të mirë duke kërkuar nga partitë që hyjnë në koalicion të emërojnë së paku çdo të tretin ministër nga gjinia e kundërt; legjislacioni i qeverisjes lokale të amendamentohet duke kërkuar që të rregullohen ligjërisht drejtoritë komunale dhe të obligohen partitë në qeverisje lokale që së paku çdo i treti i emëruar për drejtori komunale të jetë i gjinisë së kundërt; si dhe subjektet politike t'i fusin në statute të partive obligimet për emërim të grave në poste udhëheqëse aty ku ato subjekte janë të përfaqësuara.

Sami Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje ka potencuar që kuota gjinore tenton ta mbrojë femrën nga shoqëria. Ndër të tjera, Kurteshi ka thënë se duhet të ketë emancipim të femrës në shoqëri si tërësi, për të pasur pastaj përfaqësim më të mirë në politikë.

Ahmet Isufi nga AAK-ja ka theksuar se, përkundër sfidave që kemi, Kosova ka shënuar përparim në çështjet gjinore, duke qenë kështu në mesin e 30 vendeve me më së shumti gra në Kuvend. "AAK-ja si subjekt ka kuotën 30 për qind, por nuk është e mjaftueshme", ka thënë ai. Sipas Isufit, në qeveri ka përfaqësim të pamjaftueshëm të gruas. "Në ligjin e ri që është duke u hartuar duhet të merret parasysh kjo çështje. Duhet të ndryshohet edhe ligji për zgjedhje dhe çdo e dyta kandidate duhet të jetë grua", ka thënë Isufi.

Jehona Lushaku ka thënë se struktura legjislative është e avancuar nëse do të zbatohej, por shteti çalon në mekanizma për implementimin e këtij ligji. Ajo ka thënë se kuota është një garanci. "Kuotat janë garanci e fundit që garanton një përfaqësim", ka thënë Lushtaku, duke shtuar se fuqizimi i gruas varet shumë nga ndryshimet shoqërore, por partitë politike mund të kenë një rol kyç në këtë proces.

Deputetja Safete Hadërgjonaj ka thënë se fuqizimi i gruas në pozicione udhëheqëse ndodh vetëm kur kemi fuqizim të gruas brenda subjekteve politike. Ajo ka shtuar se kuota gjinore u ka mundësuar grave që ta japin kontributin e tyre në institucione dhe shoqëri.

Ambasadori i Turqisë: Do ta përkrahim Kosovën për avancimin e mekanizimeve të sigurisë

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pritur të premten në një takim njoftues ambasadorin e ri të Turqisë në Kosovë, Cagri Sakar. Me këtë rast të dy bashkëbiseduesit vunë në pah bashkëpunimin ekzistues mes dy shteteve në asketin e sigurisë. Ministri Mustafa e falënderoi ambasadorin Sakar për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë Republika e Turqisë për ngritjen e kapaciteteve për agjencitë e zbatimit të ligjit, sidomos sa i përket shkëmbimit të përvojave mes policive të dy vendeve.

Në këtë takim u bisedua edhe për shkëmbimin e informatave mes dy policive për luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit etj. Ministri Mustafa ka kërkuar përkrahjen e Turqisë për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare të sigurisë. Ndërkaq ambasadori i Turqisë në Kosovë, Cagri Sakar, ka vlerësuar lart bashkëpunimin mes dy vendeve dhe ka ritheksuar se, sikurse deri më tani, shteti i tij do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në të gjitha fushat, në veçanti në avancimin e mekanizimeve të sigurisë.

Haradinaj: Qeveria do të vazhdojë t'i mbështesë prodhuesit vendorë

Suharekë, 8 mars (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar të premten kompaninë "International Plastic" në Studenqan të Suharekës. Ai ka thënë se kjo kompani ka siguruar një treg ndërkombëtar, duke eksportuar në Gjermani, Zvicër dhe Austri. "Kjo kompani, me pronar Skender Gashin, duke prodhuar mbi 70 lloje të produkteve plastike, metal plastikë dhe elemente të ndryshme të plastikës, ka dhënë kontribut të çmuar në ekonominë e vendit, duke punësuar dhjetëra persona dhe duke qenë taksapagues i rregullt", ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se Qeveria e vendit do ta vazhdojë mbështetjen e prodhuesve vendorë edhe në "vitin e ekonomisë". "Ky është prioritet në agjendën tonë të çdoditshme. Sepse vetëm duke u bërë zot të vetës ne e përmirësojmë mirëqenien dhe ekonominë e vendit", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Murtezaj dhe Qalaj, të pakompromis në luftimin e ekonomisë joformale

Prishtinë, 8 mars (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, me bashkëpunëtorë, është pritur në takim nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, me të cilin kanë diskutuar rreth bashkëpunimit të deritanishëm, me theks të veçantë shtimit të bashkëpunimit në të ardhmen.

Drejtori Murtezaj e ka falënderuar drejtorin Qalaj për mbështetjen e ofruar për ATK-në në çdo kohë kur ka qenë i nevojshëm bashkëpunimi me policinë. Ai ka potencuar se shumë aktivitete të ATK-së janë gati të pamundura pa asistimin e Policisë së Kosovës andaj, sipas tij, në mënyrë që të vazhdohet edhe më fuqishëm luftimi dhe parandalimi i dukurive negative, mbështetja e policisë është e domosdoshme.

Ndërsa drejtori Qalaj ka ofruar përkrahje të plotë për ATK-në, për të qenë të pakompromis në parandalimin dhe luftimin e të gjitha dukurive që ndërlidhen me ekonominë joformale. Në këtë takim është thënë se ATK-ja është e përkushtuar ta parandalojë dhe ta luftojë shmangien tatimore si dhe çdo vepër tjetër penale që lidhet me tatimet.

Oda Amerikane kërkon që emërimet në pozita të larta publike të bazohen në profesionalizëm

> "Pavarësisht prej mbështetjes që ofrohet për procesin e rekrutimeve publike, Kosova vazhdon të ballafaqohet me emërime në pozita udhëheqëse publike, të individëve të cilët nuk e kanë ekspertizën e nevojshme profesionale dhe nuk demonstrojnë sjellje në pajtim me ligjin dhe standardet më të larta etike

Prishtinë, 8 mars (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë beson se organizatat e pavarura publike duhet të jenë të mbrojtura nga ndikimi politik. Në këtë aspekt, Oda Amerikane ka shprehur shqetësimin lidhur me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërimin e udhëheqësisë së re të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës në kundërshtim me rekomandimin i cili ka pasuar një proces transparent dhe meritokratik të rekrutimit. "Pavarësisht prej mbështetjes që ofrohet për procesin e rekrutimeve publike, Kosova vazhdon të ballafaqohet me emërime në pozita udhëheqëse publike, të individëve të cilët nuk e kanë ekspertizën e nevojshme profesionale dhe nuk demonstrojnë sjellje në pajtim me ligjin dhe standardet më të larta etike. Prandaj, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e saj të thellë lidhur me faktin se deputetët e Kuvendit mbështetën vendimin e tyre në nepotizëm në vend të profesionalizmit, kështu që u bënë thirrje atyre ta vlerësojnë meritokracinë në vend të lidhjeve politike, për të mirën e qytetarëve të Kosovës", është thënë në reagimin e Odës Amerikane.

'TREPÇA' REGJISTROHET SI SHOQËRI AKSIONARE

Gjiganti metalurgjik "Trepça" të premten është regjistruar si shoqëri aksionare në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Këtë lajm e ka bërë me dije ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. Regjistrimi i "Trepçës" si shoqëri aksionare pason pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës javë më parë të statutit të "Trepçës"

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 8 mars - Gjiganti metalurgjik "Trepça" të premten është regjistruar si shoqëri aksionare në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Këtë lajm e ka bërë me dije ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. "Është kënaqësi dhe privilegj që sot pata nderin që, bashkë me zëvendëskryeministrin Dardan Gashi, ta dorëzoj certifikatën e regjistrimit të biznesit të kombinatit metalurgjik 'Trepça' tek ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka. Tashmë gjiganti metalurgjik 'Trepça' i takon edhe zyrtarisht shtetit dhe popullit të Kosovës ashtu siç i ka takuar gjithmonë. Urime qytetarë të Kosovës dhe punëtorëve të 'Trepçës'", ka shkruar Shala



në llogarinë e vet në "Facebook".

Regjistrimi i "Trepçës" si shoqëri aksionare pason pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës javë më parë të statutit të "Trepçës". "Trepça" tash do të jetë shoqëri aksionare, ku 80 për qind e aksioneve do të jenë të Qeverisë së Kosovës dhe 20 për qind do t'u përkasin punonjësve të "Trepçës".

Kombinati metalurgjik "Trepça" gjendet në Komunën e Mitrovicës. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, e ka quajtur moment historik pranimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit të Kombinatit Metalurgjik "Trepça". "Moment historik. 'Trepça' regjistrohet si shoqëri aksionare. Të dashur minatorë e qytetarë, sapo u regjistrua 'Trepça' si shoqëri aksionare. Tashmë edhe zyrtarisht punëtorët e kësaj ndërmarrje janë pronarë të këtij gjiganti metalurgjik. Urime! Kemi shumë punë për të bërë, por ky hap historik definitivisht do të lehtësojë çdo proces tash e tutje dhe për këtë ndihem i lumtur. Dua t'i falënderoj të gjithë ata që ndihmuan në këtë proces, përfshirë të gjithë anëtarët e bordit të Trepçës, menaxhmentin, sindikatën, kolegët në qeveri, veçanërisht deputetët e Kuvendit të Kosovës", ka shkruar Lluka në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se, më në fund, erdhi lajmi i madh. "Të dashur qytetarë dhe minatorë, më në fund lajmi i madh. Gjiganti 'Trepça', pas votimit në Kuvend të statutit të saj, është regjistruar si kompani në bazë të ligjeve të Kosovës. Punë të mbarë e me fat!", ka shkruar Haradinaj.

Syla: 'Trepçës' tani i hapen rrugët për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Kombinatit "Trepça", Ardian Syla, ka thënë se sot përfundimisht përfundoi regjistrimi i "Trepça sh.a" si shoqëri aksionare e Republikës së Kosovës. "Kjo është ngjarje historike për shtetin e Kosovës dhe gjithë punëtorët e 'Trepçës' pasi që nga sot ndërmarrja 'Trepça' shoqëri aksionare ekziston, nga sot të gjithë punëtorët gëzojnë të drejtën e tyre si aksionarë në 'Trepçë'. Por, më e rëndësishmja është që nga sot i hapen rrugët për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të 'Trepçës' përmes hapjes së rrugëve për investime", ka thënë Syla, duke falënderuar të gjithë ata që kontribuuan për këtë moment historik.

Drejtoritë komunale në Mitrovicë nderojnë nënat vetushqyese me rastin e festës së 8 Marsit

Mitrovicë, 8 mars (ER) - Drejtoresha e Shëndetësisë në Komunën e Mitrovicës, Erseka Hasanaj-Barani, e shoqëruar nga drejtoresha për Integrime Evropiane dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi, kanë pritur në objektin e ndërtesës komunale disa nëna vetushqyese me rastin e festës së 8 Marsit - Ditës së Gruas.

Arsyeja e këtij takimi ishte që këtyre nënave për nder të kësaj feste t'u mundësohet kryerja e mamografisë falas në mënyrë që shëndeti i tyre të jetë primar. Dy drejtoritë komunale u përkujdesen që t'u dhurohet edhe nga një dhuratë simbolike.

Drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, ka thënë se ky është një aktivitet simbolik nga ana e dy drejtorive kushtuar Ditës së Grave, për t'i nderuar ato dhe për t'i parë për së afërmi hallet me të cilat përballen. Ajo ka thënë se komuna vazhdimisht përpiqet t'u ndihmojë atyre dhe, sipas saj, për këtë arsye kanë organizuar edhe një mamografi falas që të sigurohen që shëndeti i tyre të jetë i mirë.

Edhe drejtoresha për Integrime Evropiane dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi, ka uruar nënat përzgjedhëse për festën e tyre, me shpresën se çdo vit i tyre të jetë sa më i mirë. Në fund nënat përzgjedhëse, së bashku me drejtoreshat, vazhduan tek QKMF "Nexhat Çuni", me ç'rast janë pritur nga drejtori i QKMF-së, Fevzi Sylejmani, ku kryen të gjitha kontrollet e nevojshme mjekësore të mamografisë.

Në Prizren hapet ekspozita 'Hasjania'

Prizren, 8 mars (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në hapjen e ekspozitës së skulptorit Luan Mulliqi, të titulluar "Hasjania", e cila u organizua në Galerinë e Hamamit në Prizren, aktivitet ky i organizuar nga MKRS-ja pas hapjes së zyrave të saj në qytetin jugor të Republikës së Kosovës.

Ministri Gashi me këtë rast u shpreh se në ditën më të rëndësishme të arsimit shqip, më 7 mars, është hapur kjo ekspozitë. "Ju do të pyesnit se çfarë lidhje ka 7 marsi me hasjanët. Unë do të thosha se mësuesi i shkrimtarëve të parë shqiptarë ishte Pal Hasi, nga i cili kishin mësuar Gjon Buzuku e Pjetër Budi, për të vazhduar më pas me Pjetër Bogdanin e Pjetër Mazrrekun që, gjithashtu, janë nga Hasi i Skënderbeut. Andaj edhe unë u lumturova kur dëgjova për këtë ekspozitë dhe me kënaqësi e pranova që të jetë nën organizim të Ministrisë për Kulturë, Sport dhe Rini", u shpreh ministri Gashi.

Ai ka folur edhe për artistin Luan Mulliqi, me ç'rast ka vlerësuar se prania e tij e nderon qytetin e Prizrenit. Gashi ka thënë se akademik Mulliqi ka realizuar ekspozita personale në vende të ndryshme të botës si dhe në hapësirën mbarëshqiptare, këtë radhë vjen edhe në Prizren, në qytetin shpirtëror të shqiptarëve.

Skulpturat që u paraqitën në këtë ekspozitë janë të punuara nga mermeri, bronzi, druri, alumini, magoni e materiale të tjera, klasike e moderne, dhe përmes tyre synohet të dëshmohet se trashëgimia jonë kulturore duhet të pasqyrohet sa më shumë brenda dhe jashtë vendit.

Universiteti i Mitrovicës përkrah Programin Nacional për Rininë

Mitrovicë, 8 mars (ER) - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" nga e premtja do të jetë pjesë e Programit Nacional për Rininë, pasi që koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rektorin e Universitetit, Alush Musaj. Me këtë rast, koordinatori Hoti ka thënë se e gëzon fakti që universitetet publike dhe ato private po e mbështesin dhe po e kuptojnë seriozitetin e programit. "Programi Nacional për Rininë është i hartuar ekskluzivisht për të gjithë nxënësit dhe studentët e Republikës së Kosovës. Është një mundësi e jashtëzakonshme që u ofrohet studentëve qoftë për të garuar mes vete, qoftë për të ndihmuar në mbarëvajtjen e garës. Studentët janë pjesa më e rëndësishme e shoqërisë dhe unë do të angazhohem që ata ta kenë hapësirën e munguar. Programi Nacional e ka si synim edhe ngritjen e vetëdijes për punë vullnetare, për të cilën nuk dyshoj se studentët e 'Isa Boletinit' do ta bëjnë më së miri", ka thënë Hoti.

Ndërsa rektori Musaj e ka mirëpritur bashkëpunimin me nivelin qeveritar për të mirën e studentëve. Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin "Isa Boletini" përcakton angazhimet e ndërsjella të palëve nënshkruese për implementimin e Programit Nacional për Rininë dhe për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve që kanë të bëjnë me përfshirjen e studentëve në garat e kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik si dhe të sportit.

Suhareka dhe Rahoveci përfitojnë financim të projekteve infrastrukturore lokale

Prishtinë, 8 mars (ER) - Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, në kuadër të mbështetjes financiare për komunat, priti në takime të ndara kryetarin e Komunës së Suharekës dhe atë të Rahovecit, me ç'rast nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi.

Komuna e Suharekës nga mbështetja e MIT-së për vitin 2019 përfiton mbështetje në pesë projekte në vlerë prej 1.063.367 eurosh, kurse ajo e Rahovecit përfiton mbështetje për dy projekte në vlerë prej 220 000 eurosh për këtë vit, kurse në dy vjetët e ardhshëm janë paraparë të ndahen edhe 1 280 000 euro për përmbylljen e këtyre projekteve.

Për Rahovecin, Lekaj ka bërë me dije edhe lajmin për fillimin e punimeve për zgjerimin e rrugës në katër korsi, nga Rahoveci deri në Xërxë, projekt ky me vlerë rreth 3.5 milionë euro.

Ministri Lekaj ka thënë se komunat në vazhdimësi do ta kenë mbështetjen e nivelit qendror, në këtë rast të MIT-së, kur dihet se mundësitë e tyre janë të vogla për të përballuar projekte që kërkojnë shuma të mëdha financiare për realizimin e tyre.

Dy kryetarët e komunave nënshkruese të marrëveshjeve të bashkëpunimit konstatuan se kjo ndihmë e MIT-së për komunat është me rëndësi të madhe dhe mbështetje e munguar ndër vite.

Kërkohet angazhim më i madh shoqëror për barazinë gjinore

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsit, Avokati i Popullit, si mbrojtës i të drejtave të njeriut, ka kërkuar angazhim më të madh shoqëror dhe institucional për barazinë gjinore. Ndërkaq presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se përpjekjet për lirinë dhe barazinë e secilit në shoqëri vazhdojnë të jenë të nevojshme edhe sot

EPOKA E RE — Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MARS - Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Avokati i Popullit, si mbrojtës i të drejtave të njeriut, ka kërkuar angazhim më të madh shoqëror dhe institucional për barazinë gjinore. Ky institucion ka kërkuar që legjislacioni primar si dhe standardet e përcaktuara në instrumentet dhe konventat ndërkombëtare të gjejnë zbatim të plotë dhe faktik, duke u bërë të prekshme dhe arritshme për secilën vajzë dhe grua. "Njëherësh, parimi i shtetit të së drejtës, si

parim themelor i Kushtetutës dhe Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, duhet të jetë prioritet për të gjitha organet shtetërore si dhe kërkon rol aktiv të tyre për sigurimin dhe zbatimin e obligimeve kushtetuese dhe ligjore. "Fenomenet destruktive, siç janë dhuna në baza gjinore dhe ajo seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore, martesat e hershme etj., vazhdojnë të mbesin probleme që ndikojnë dhe prekin kryesisht vajzat dhe gratë. Në anën tjetër, angazhimi i pamjaftueshëm institucional dhe shoqëror për sigurimin e të drejtës në arsim cilësor, punësim të denjë dhe qasje të barabartë në pronë apo resurse financiare, vetëm sa e thellojnë ndarjen dhe pabarazinë gjinore ne vend, duke u hapur rrugë fenomeneve të dëmshme për zhvillimin e një shoqërie të emancipuar dhe prosperuese", është thënë në komunikatën e Avokatit të Popullit.

Ky institucion ka vlerësuar se një shoqëri e barabartë në aspektin gjinor pashmangshëm nënkupton edhe pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës publike, duke filluar nga përfaqësimi i grave në pozita të larta vendimmarrëse e deri te përfshirja e tyre në planifikimin dhe hartimin e politikave publike, të cilat ndikojnë në jetesën dhe mirëqenien e të dy gjinive. Megjithatë, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij sa i përket hapësirës dhe mundësive reale që grave u jepen për të qenë pjesë e drejtimit dhe vendimmarrjes institucionale. Përfaqësimi i barabartë i burrave dhe grave, i garantuar përmes Ligjit për Barazi Gjinore, ndonëse do të duhej të ishte standard i padiskutueshëm, vazhdon të mbesë çështje e vullnetit politik. Nisur nga kjo, Avokati i Popullit rithekson obligimin e autoriteteve për të vepruar në praktikë dhe të sigurojnë që parimi i barazisë të mos mbetet vetëm vlerë e garantuar "de jure", por edhe "de fakto".

Presidenti Hashim Thaçi me rastin e 8 Marsit, Ditës së Gruas, ka thënë se ditët si kjo e sotmja janë mundësia më e mirë për të reflektuar për punën dhe sakrificën e madhe që bëjnë gratë për mirëqenien e përditshme në jetën tonë. "Përpjekjet për lirinë dhe barazinë e secilit në shoqëri vazhdojnë të jenë të nevojshme edhe sot. Megjithatë, krahasuar me të kaluarën, sot kemi shumë arsye për të festuar. Gëzuar 8 Marsin të gjitha grave që pareshtur angazhohen dhe punojnë për ta bërë më të mirë shoqërinë në të cilën jetojmë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq në urimin e tij për 8 marsin, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se, pavarësisht prej sfidave dhe pengesave përgjatë historisë sonë, roli i gruas është i pazëvendësueshëm. "Përkushtimi juaj deri në flijim për familjen, është për admirim", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka uruar gratë dhe nënat për ditën e 8 Marsit. Limaj ka thënë se gratë janë shtyllë e shoqërisë. Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka vënë lule edhe te memoriali "Heroinat" në Prishtinë me rastin e 8 marsit.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se 8 marsi shënon një prej datave të rëndësishme për shoqërinë tonë. "Është festa e grave, të cilat nuk reshtën asnjëherë së luftuari për kërkesat e tyre. Përkundër sfidave të shumta që u përballën me jetën dhe shoqërinë, ato nuk u dorëzuan. Ato u shndërruan në simbol të sakrificës dhe përkushtimit për t'i ndryshuar dhe ndërtuar vlerat e mirëfillta në shtetin tonë", ka thënë Mustafa në urimin e tij.

Ndërkaq kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ka thënë se barazia gjinore do t'i sillte Kosovës vetëm zhvillim. "Jam i bindur se barazia gjinore do t'i sillte Kosovës vetëm zhvillim në të gjitha sferat. Sot 80 për qind e grave janë të përjashtuara nga tregu i punës, dhe prej pjesës së mbetur, vetëm 60 për qind punon. Pra, 7 prej 8 grave janë të papuna. Kjo është përqindje skandaloze. Gratë duhen ndihmuar për solidaritet gjinor, sepse konkurrenca pa bashkëpunim është rrënim", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Veseli për 8 Mars pret ish-ushtaret e UÇK-së dhe policet e Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ka pritur në takim disa ish-ushtare të UÇK-së dhe police të Kosovës. "Sot kisha nderin e veçantë t'i takoj bashkëluftëtaret e mia, ish ushtaret e UÇK-së, si dhe policet e Kosovës, për t'i uruar për 8 marsin. Asgjë e madhe në Kosovë nuk është bërë pa përkushtimin dhe sakrificat e grave të saj. Sot ato janë krenaria jonë kudo në botë ku flitet e dëgjohet emri i atdheut tonë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Reçica: Gruaja është simbol i sakrificës

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka vizituar të premten rezidentet gra në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë, me rastin e 8 Marsit, Ditës së Gruas. I pari i Punës dhe Mirëqenies Sociale ka thënë se MPMS-ja do të mbetet e angazhuar për rritje të mirëqenies për të gjitha kategoritë, me fokus për gratë. "Gruaja është simbol i sakrificës. Trajtimi meritor dhe dhënia e mundësive të barabarta është obligim i gjithsecilit nga ne si pjesë e shoqërisë. Le të shërbejë kjo ditë për rritje të përpjekjeve për avancim të të drejtave të grave", ka thënë ministri Reçica.

E jashtëzakonshme

Prifti 'ringjall' të vdekurin nga arkivoli, paditet

Një grup drejtuesish funeralesh në Afrikën e Jugut thonë se do të padisin një profet të vetëshpallur dhe që pretendon të ketë ringjallur të vdekurit. Një video virale e pastorit Alph Lukau tregon momentin kur ai bërtet 'ngrihu' pranë një burri të shtrirë në një arkivol, shkruan "BBC". Më pas, burri ngrihet në këmbë, duke shkaktuar entuziazëm te të pranishmit. Prifti i bindi ndjekësit e tij se ringjalli me sukses njeriun e Kompanitë funerale thanë se ishin manipuluar duke u përfshirë në rast.

FOTO E DITES

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, një burrë mbart një kovë me buqeta lulesh në një treg në Minsk të Bjellorusisë. /AP/

E rrallë

Nuk lau mirë enët, gruaja mbyll bashkëshortin në papafingo

Një burrë nga Roma nuk dinte t'i lante mirë enët dhe, po ashtu, nuk dinte t'i varte rrobat e lara në tel. Kështu që, gruaja e tij 48-vjeçare për këto dy gabime e mbyllte bashkëshortin në papafingo, në shtëpinë e tyre në Monteverde, në një lagje të Romës. Keqtrajtimet vazhduan për vite të tëra, derisa vëllai i viktimës vendosi ta denoncojë gruan në polici.

BARSOLETA E DITËS

A e dini se si i jep bakshish gjakovari muzikës?
E tërheq kartën e kreditit nëpër harmonikë.

KINO ABC PRISHTINE

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Entuziazmin e munguar po filloni ta gjeni përsëri sot në detaje të vogla dhe në ambientin e ngrohtë familjar.

DEMI
Po hidhni argumente që nuk jeni të gatshëm t'i mbështesni në ditët në vijim. Mbase një ndryshim strategjie do të ishte më i mirë.

BINJAKËT
Puna për ju sot do të jetë një burim kënaqësie. Bashkëpunimi me kolegët ju ka bërë që të përfitoni bonuse mjaft të mira morale dhe materiale.

GAFORRJA
Po lini pas dore raportet tuaja personale dhe sidomos ato që iu përkasin ndjenjave. Kur të kërkoni miqtë tuaj do të vini re distancat.

LUANI
Nëse nuk jeni të kënaqur nga ajo që po bëni kohët e fundit, është mirë të ndaleni dhe të mendoni qartë se kush është prioriteti juaj.

VIRGJËRESHA
Doni të vazhdoni projektet që keni nisur, por rrethanat nuk do t'ju lejojnë ta bëni këtë gjë. Ndryshoni drejtim në kohën e duhur.

PESHORJA
Gjëja më e mirë është heshtja kur shihni që përreth jush situatat dhe personat janë duke krijuar rrëmujë. Më pas gjithçka do të qartësohet.

AKREPI
Personat gri që rrinë rreth jush nuk kanë pasur asnjëherë asnjë ide dhe nuk ju kanë propozuar asgjë deri tani. Bëni mirë të bëni dallime.

SHIGJETARI
Sot duhet të veproni vetëm për veten tuaj. Duke marrë rolin e të tjerëve i keni hequr vetes mundësitë të dëgjoheni në ambiente të ndryshme.

BRICJAPI
Jeni të pavarur në vendimet tuaja sot dhe kjo ju ka krijuar mjaft liri veprimi. Përfitimet e kësaj gjeje do t'i përjetojnë edhe familjarët tuaj.

UJORI
Keni kërkuar prej kohësh mënyrën më të mirë për të zgjidhur disa ngërçe që po verifikohen në ambientin e punës. Nëse nuk ia dilni, mbase është momenti të ndaloni.

PESHQIT
Keni zgjedhur një rrugë të mesme sot për t'i arritur objektivat tuaj. Edhe pse do të keni kritika, jeni ju që merrni vendimet për veten.

Rita Ora duket e mrekullueshme në këngën e fundit

Këngëtarja me prejardhje nga Prishtina, Rita Ora, ka publikuar këngën më të re. Kjo këngë quhet "Only want you" dhe është në bashkëpunim me 6LACK. Ora duket e mrekullueshme në këtë videoklip.

Cheryl shkëlqen sërish

Këngëtarja e famshme nga Britania, Cheryl, së fundi ka marrë pjesë në mbrëmjen e eventit "Global Awards". Cheryl dukej e mrekullueshme me fustanin që pati të veshur. Ky fustan ishte shumëngjyrësh dhe ishte me shkëlqim.



Bebe Rexha duket e mrekullueshme në të zeza

Këngëtarja me prejardhje shqiptare, Bebe Rexha, në disa postime që ka bërë të premten në rrjetin social "Instagram", duket e mrekullueshme. Rexha pati të veshur pantallona të zinj dhe një bluzë për trupi. Ky kombinim i rrinte shumë mirë këngëtares.

Reese Witherspoon kalon shumë kohë me qenin

Aktorja hollivudiane Reese Witherspoon është e lumtur kohët e fundit, pasi ajo është duke kaluar shumë kohë me qenin. Këtë e dëshmoi vetë Witherspoon me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram", ku ka shpërndarë një fotografi duke qëndruar me qenin. "Miku, nuk e lë mikun të pijë vetëm", ka shkruar Reese në mbishkrimin e fotografisë së saj.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	CHIEVO - MILAN	2	DORTMUND - SHTUTTGART	1	MONACO - BORDEAUX	1

Islami: Ndaj Gjilanit iu rikthehemi fitoreve

Përparim Islami ka thënë për "Epokën e re" se skuadra e Feronikelit është e gatshme ta mposhtë Gjilanin të dielën në stadiumin "Rexhep Rexhepi". "Tash në fundjavë e kemi një ndeshje shumë të rëndësishme ndaj Gjilanit. E kemi përgatitur shumë mirë këtë ndeshje dhe duhet të kemi kujdes se Gjilani ka një ekip shumë të mirë dhe nuk ka presion për ta fituar ndeshjen dhe mund të na shkaktojë shumë telashe. Do ta japim maksimumin në këtë ndeshje për t'iu rikthyer fitoreve", ka thënë Përparim Islami

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 MARS - Skuadra lidere e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Feronikeli, është gati t'iu rikthehet fitoreve në ndeshjen ndaj Gjilanit, e cila zhvillohet të dielën në Drenas. Në fakt, "Nikli" barazoi në mesjavë në derbin ndaj Prishtinës (1-1), në stadiumin "Fadil Vokrri". Mbrojtësi Përparim Islami të premten për "Epokën e re" ka thënë se ndaj Gjilanit kërkohen pikët maksimale në mënyrë që skuadra lidere ta vazhdojë rrugëtimin drejt titullit kampion në elitë. "Tash në fundjavë e kemi një ndeshje shumë të rëndësishme ndaj Gjilanit. E kemi përgatitur shumë mirë këtë ndeshje dhe duhet të kemi kujdes se Gjilani ka një ekip shumë të mirë dhe nuk ka presion për ta fituar ndeshjen dhe mund të na shkaktojë shumë telashe. Do ta japim maksimumin në këtë ndeshje për t'iu rikthyer fitoreve", ka thënë Islami, i cili është shumë i lumtur se skuadra nuk do të ketë mungesa në këtë ndeshje, e cila është e vlefshme për javën e 22-të. "Një tjetër plus është se nuk kemi mungesa për këtë ndeshje dhe atmosfera është e mirë. Nuk duhet të gabojmë ndaj Gjilanit, pasi kundërshtarët do ta ngushtojnë diferencën e pikëve", ka shtuar ai.

Në fund mbrojtësi i transferuar gjatë verës nga Trepça '89 ka treguar edhe një herë ambiciet e skuadrës së Feronikelit për të triumfuar në të dyja frontet: kampionat dhe Kupë. "Ambiciet e klubit tonë janë që ta fitojë titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës. Aktualisht jemi të parët dhe këtë pozitë duhet ta ruajmë deri në fund të kampionatit dhe t'i shpërblejmë tifozët për përkrahjen e vazhdueshme që po na japin", ka deklaruar ai.

Feronikeli, që pozicionohet në pozitën e parë, ka aktualisht pesë pikë më shumë se dy Prishtina dhe Llapi. Dy ndeshjet e para të kësaj xhiroje në elitë zhvillohen sot (e shtunë), ku takohen Drita - Ferizaj dhe Llapi e Trepça '89, kurse të dielën, përveç ndeshjes Feronikeli - Gjilani, zhvillohen edhe tri ndeshje të tjera.

IPKO SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
Drita - Ferizaj
Llapi - Trepça '89

Të dielën takohen:
Liria - Drenica
KEK-u - Prishtina
Feronikeli - Gjilani
Flamurtari - Ballkani

Liga e Parë

Të shtunën takohen:
Onix - Ramiz Sadiku
Arbëria - Drenasi

Të dielën takohen:
Besa - Fushë-Kosova
Vëllaznimi - Dukagjini
Trepça - Istogu
Vitia - Bashkimi
Kika - 2 Korriku
Vllaznia (P) - Vushtrria

SHKURT

Tovërlani konfirmon bisedimet me Gjilanin

Kryetari i Klubit të Gjilanit, Florim Zuka, dhe trajneri i njohur Afrim Tovërlani kanë zhvilluar një takim të premten. Arsyeja e takimit është që "Toki" ta marrë drejtimin e kësaj skuadre. "Ishte një takim ku u diskutua për shumë gjëra. Kemi diskutuar edhe për mundësinë e bashkëpunimit. Ka mbetur të takohemi sërish", ka deklaruar Tovërlani për "Gazetasheshi.com". Nga Gjilani ditë më parë është larguar trajneri Sadat Pajaziti dhe aktualisht skuadrën po e drejton Alban Hyseni.

Salihu në mitingun e UEFA-s

Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, po merr pjesë në Mitingun e UEFA-s, me të gjithë sekretarët e përgjithshëm të federatave anëtare të UEFA-s. Gjatë këtij mitingu po diskutohet strategjia digjitale dhe komerciale e UEFA-s si dhe për sfidat dhe mundësitë. Gjithashtu, u diskutua edhe për të ardhmen e garave të organizuara nga UEFA si dhe për përditësimin e ngjarjeve nga FIFA.

Reali e dëshiron Alaban në vend të Marcelos

Mbrojtësi brazilian i Real Madridit, Marcelo, në verë pritet të transferohet në Juventus. "Goal.com" raporton se drejtuesit e Realit e kanë etiketuar si pasardhës të brazilianit mbrojtësin e Bayern Munchenit, David Alaban. Reali është gati të paguaj dëmshpërblim për mbrojtësin austriak i cili është pjesë e Bayernit që nga viti 2011.

Kastrioti - Besa përballen në palestrën 'Bill Clinton'

Derbi i madh në hendbollin e Kosovës në mes të Kastriotit dhe Besa Famgasit luhet të shtunën nga ora 19:00 në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj. Derbi luhet në kuadër të javës së 20 të Superligës A për hendbollistë. Skuadra pejane Besa ka dominuar në hendbollin kosovar në vitet e fundit duke mbledhur të gjithë trofetë, por këtë edicion Kastrioti i Ferizajt po e rivalizon fuqishëm. Madje Kastrioti prinë në tabelë me 36 pikë, dy më shumë se Besa. Kastrioti javë më parë e mposhti Besën në Ferizaj, kurse ndeshjen e luajtur në vjeshtë në Pejë e kishte fituar Besa. Të shtunën janë edhe dy ndeshjet e tjera të Superligës A: Vëllaznimi - Prishtina (18:00), Vushtrria - Drita (15:00). Në Superligën B luhet java e 19. Dy ndeshjet zhvillohen të shtunën (nesër): Trepça - Samadrexha (18:30), Drenica - Zhegra (16:00). Te femrat luhet java e 11, kurse derbi vlerësohet ndeshja Istogu - Kastrioti që zhvillohet të dielën nga ora 18:00.

Fillon shitja e biletave, çmimi nga 5 deri në 80 euro

PRISHTINË, 8 MARS - Të premten ka filluar shitja e biletave për dy ndeshjet e këtij muaji që Përfaqësuesja A do t'i zhvillojë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kosova më 21 mars do të luajë ndeshje miqësore me Danimarkën, kurse më 25 mars do ta luajë ndeshjen e parë për ciklin kualifikues "Euro2020" kundër Bullgarisë. Edhe kësaj radhe shitja e biletave po bëhet nëpërmjet platformës online në internet në "linkun: www.tiks.app". Çmimi më i ulët për bileta është 5 euro për tribunat në veri dhe jug, ndërsa në lindje çmimi është nga 10 deri në 15 euro, kurse në përmendim nga 15 deri në 20 euro. Biletat më të shtrenjta janë në tribunat VIP, që kushtojnë 80 euro.

Oklahoma fiton pas kohës shtesë

Oklahoma, 8 mars - Dy ndeshje të luajtura në NBA. Skuadra e Oklahomës triumfoi 129-121 pas kohës shtesë ndaj Portlandit, ndeshje me rivalitet përgjatë gjithë kohës. Lillardi realizoi 51 pikë për vendësit, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërkohë që për Oklahomën u dalluan Westbrooku me 37 pikë e George me 32 pikë e 14 rebounde. Fiton edhe skuadra e Milwaukees, që mundi 117-98 Indianan, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Bucksit. Antetokounmpo realizoi 29 pikë e 12 rebounde, mbështetur edhe nga Middletoni me 27 pikë, një dyshe që bëri diferencën në parket. Për miqtë u dallua Turner me 22 pikë e 17 rebounde, por që mbetën për statistikë.

Derbi Prishtina - Rahoveci

Prishtinë, 8 mars - Pas ndeshjes Kosova - Rumania, pastaj "Final 8" të Kupës së Kosovës dhe krejt në fund duelit në mes të Z Mobile Prishtinës dhe Pallacanestro Vareses, tashmë basketbollit të Kosovës i kthehen ndeshjet e Superligës së Kosovës me ndeshjet e xhiros së XX-të që do të luhen të shtunën dhe të dielën.

Të shtunën janë në program dy ndeshje dhe të dielën dy të tjera. Të shtunën, me fillim nga ora 17:00, AFK Borea është nikoqire e Bashkimit, kurse dy orë më vonë, Z Mobile Prishtina do të ballafaqohet në kryeqytet me Rahovecin. Ndërkaq të dielën, duke filluar nga ora 17:00, në palestrën "Minatori" në Mitrovicë do të zhvillohet ndeshja më interesante e kësaj xhiroje, ajo në mes të Trepçës dhe Ponte Prizrenit. Dueli i fundit do të luhet në Lipjan, ku Lipjani është nikoqir i Golden Eagle Yllit, takim ky që do të zhvillohet nga ora 19:00.

Duhet theksuar se Z Mobile Prishtina kryeson në renditjen tabelore të Superligës së Kosovës, ku nga 19 ndeshje ka shënuar po aq fitore dhe ka grumbulluar 38 pikë, kurse Golden Eagle Ylli zë pozitën e dytë me 31 pikë, me 12 fitore e 7 humbje, derisa bilanc të njëjtë ka edhe Rahoveci në vendin e tretë, kurse Trepça është e katërta me 28 pikë, 9 fitore e 10 humbje, me bilanc të njëjtë si Ponte Prizreni dhe Bashkimi. Lipjani është në pozitën e parafundit me 22 pikë, një më shumë se AFK Borea që është në vendin e fundit.

Wilderi më 18 maj mbron titullin

Nju Joruk, 8 mars - Kampioni i botës në peshën e rëndë, boksieri amerikan Deontay Wilder, do të duelojë më 18 maj ndaj patriotit të tij Dominic Breazeale. Dueli është zyrtarizuar sot nga "Showtime", kompania që do të organizojë këtë sfidë, e cila do të zhvillohet në "Madison Square Garden" të Nju Jorkut. Wilder, 40 fitore e 1 barazim, do ta mbrojë titullin e kategorisë WBC, ndërkohë që mësohet se atij i janë ofruar 12.5 milionë dollarë. Kjo do të jetë një sfidë PPV (pay per view-paguaj për ta parë), por vështirë se kjo përballje do ta kalojë shifrën e 320 mijë shitjeve që dhuroi dueli Wilder-Fury, zhvilluar në dhjetor. "Unë jam i lumtur që më jepet kjo mundësi dhe do t'i tregoj Wilderit se nuk do të jetë një sfidë e lehtë për të. Ky është një shans i artë. Kam vite që e pres këtë mundësi dhe nuk do ta çoj atë dëm", u shpreh Breazeale, me 20 fitore e 1 humbje në karrierë.



SHKURT

Guardiola arrin marrëveshje me Juven

Pep Guardiola, pas tri aventurave të suksesshme në Spanjë, Gjermani dhe, së fundi, në Angli, preferon kalimin në Itali. Një nga trajnerët më të mirë që ka pasur futbolli në histori, raportohet të ketë arritur marrëveshje verbale me Juventusin. Luigi Guelpa, gazetar i mirënjohur në Itali, ka thënë se Pep Guardiola është një hap larg Juventusit. "E dija që Guardiola do të ketë arritur marrëveshje verbale me Juventusin për katër vjetët e ardhshëm. Është i njëjti person që më tha se Ronaldo po shkonte te Juventusi. Do të ishte një tërmet", ka deklaruar Guelpa.

Ancelotti thumbon Tuchelin

Eliminimi dramatik i PSG-së nga Manchester Unitedi i ka shokuar të gjithë teksa nuk kanë munguar thumbimet për këtë disfatë të skuadrës franceze. Ish-trajneri i PSG-së, Carlo Ancelotti, i cili aktualisht drejton skuadrën e Napolit, nuk ka ngurruar ta thumbojë trajnerin gjerman Tuchel, teksa në deklaratën pas ndeshjes ndaj Salzburgut, Ancelotti u shpreh: "Ishte e pabesueshme. Po të kisha qenë në stolin e PSG-së nuk e di se çfarë do të kisha bërë. Ndoshta do ta gjeja urën më të afërt dhe do të hidhesha poshtë".

Milani refuzon tri oferta për Romagnolin

Alessio Romagnoli duket se do të qëndrojë gjatë te Milani. Mbrojtësi italian ka shkëlqyer me "Rossonerët" në vitet e fundit dhe kësisoj ka marrë edhe shiritin e kapitenit. Falë paraqitjeve të mira, Romagnoli është bërë objektiv i skuadrave të mëdha evropiane: Juventus, Manchester United dhe Chelsea. Milani ka refuzuar këto oferta pasi lojtari nuk është në shitje. "Corrierre Dello Sport" raporton se këto oferta ishin rreth 60 milionë euro për mbrojtësin italian.

Slimani kërkon rikthimin te Leicesteri

Islam Slimani, që luan i huazuar që nga 11 gushti i vitit 2018 te Fenerbahçe, kërkon rikthimin në Premierë Ligë te skuadra e Leicester Cityt, që zotëron edhe kartonin e algjerianit. 30-vjeçari nuk ka arritur të ambientohet me skuadrën e drejtuar nga Ersun Yanal dhe për këtë arsye kërkon të rikthehet në Angli dhe më pas të kërkojë një aventurë të re për karrierën e tij. Gjatë këtij sezoni, Slimani ka koleksionuar vetëm pesë gola në 25 sfida të luajtura.

Hamann: Lowi gaboi totalisht, do ta paguajë

Prej dy ditësh në Gjermani debati më i madh është ai mbi vendimin e trajnerit Joachim Low për t'ua mbyllur derën e kombëtares tre lojtarëve më shumë përvojë si Boateng, Hummels e Muller. Një vendim i bujshëm, për lojtarë që nuk e kanë kaluar moshën 40 vjeç dhe janë ende të rëndësishëm por, mbi të gjitha, Low është kritikuar për mënyrën si i përjashtoi, pa i paralajmëruar dhe duke mos e nisur revolucionin kur pritej, pas dështimit në Botëror. Këtë gjë e thekson edhe ish-mesfushori Dietmar Hamann, i cili tashmë punon si opinionist për "Sky" dhe ka qenë mjaft i ashpër në deklaratat e tij. "Nuk më besohej kur e lexova si lajm. Mendova se diçka e rëndë mund të kishte ndodhur. Nëse është thjesht rinovim ekipi, pse nuk e nisi Low sapo u mbyll Kupa e Botës? Atëherë njerëzit do ta kishin kuptuar", ka thënë Haman. "Ata lojtarë luajtën në Nations League, ndërsa tani dalin të panevojshëm për kombëtaren. Më duket e papranueshme, ata nuk e meritonin një trajtim të tillë. Low e dinte që kundër Francës dhe Holandës do të ishin katër ndeshje të vështira dhe nuk pati guxim ta rinovonte ekipin atëherë, sepse duhej të mbronte vendin e punës. Tani me një stil aspak të mirë, ai u thotë që nuk ka më nevojë për ta. Mendoj se pikërisht për këtë sjellje Low do të ketë probleme, do t'i paguajë gabimet që po bën", ka deklaruar Hamann.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Prizren

NO: 8/10
Açık: 08.03.2019
P r i z r e n
Sayılı Kanunun 8 inci maddesine dayanarak. 03 / L-212 Çalışma, İdari Eğitim (MLSW) Nr. 07/2017 Kamu Yarışması Usul İşlemleri Yönetmeliği, 626 sayılı Kanunun 6 ncı maddesi 04 / L-125 Sağlık Üzerine, Başvuru no. 14.01.2019 tarihli 2/7 ve SHSKUK Genel Müdürü'nün 18.01.2019 tarihli onayı ve 13 üncü madde, Hastane Statüsünün 1.1.

BASVURU
Süresiz çalışan aranıyor

Görev: Hukuk Görevlisi (1 Görev)
Maaş katsayısı: (7.2)
Çalışma Hızı: Tam Program (haftada 40 saat)
Sözleşme: Yürürlükteki mevzuata göre
Raporlar: Yönetici Direktörü
Nr. Referans:8/10, açık: 08.03.2019
Bir Hukuk Görevlisinin temel iş amacı
Yasal hizmetler sağlamada sorumlu ve verimli olunması. Hastane kapsamındaki yasal ve idari işlemlerin hızırlanmasında hukuki destek sağlamak. Talep üzerine hastane personeline tavsiye ve yasal tavsiye sağlayın.
Görev ve Sorumluluklar:
• Olumlu yasaları ve uygulamalarını belirlemek
• Ofis Şefinin ihtiyaç duyduğu kararların, tekliflerin ve çeşitli yasaların hazırlanması
• Tarafların davalarına ve ihtiyaçlarına göre tarafların iletişimini ve kabulünü sağlar.
• Tüm hastane personeline, yasal konularda uygun danışmanlık hizmeti sağlayarak, yasal-yasal konularda hizmetler sunar.
• Hastane ihtiyaçları için yasal hizmetler ve diğer hizmetler sunmak
• Mahkeme toplantılarını, kararlarını ve dosyalarını kabul eder, davalara, temyizlere ve diğer usul işlemlerine yanıt olarak mahkeme belgelerini hazırlar ve davayı tamamladıktan sonra ayrı bir dosyada saklar.
• Yetkiliye göre hastaneyi mahkemede çeşitli ihtilaflarda temsil eder
• Diğer ofis yetkilileri ile gerektiğinde koordine etmek ve irtibat kurmak
• Düzenli çalışma raporları oluşturur
Yeterlilik:
• Üniversite Eğitimi, Adli Yönetim
Bilgi, Beceri, Beceri, Gerekli Nitelikler:
• Hukuk Fakültesi derecesi;
• Kosova'da sağlık ve kamu hizmeti alanındaki ilgili mevzuat hakkında iyi bilgi;
• Programda bilgisayar çalışması bilgisi (Word-Exel);
• Başkalarına yardım etme ve işbirliği yapma yeteneği;
• Denetim ile çalışabilme becerisi;
• İletişim ve Müzakere Becerisi;
• Doğum belgesi;
• Kimlik kartı, fotokopi.
Gerekli Şartlar:
Bu uygulamaya eklenen belgeler geri dönmüyor
Bu belgelerin aslı veya noter tarafından onaylanmış ancak adayın iş için toplanması durumunda talep edilecektir.
İşe Alım Katılım Koşulları:
Hareket edebilmek için tam kapasiteye sahip tüm yetişkinleri olan Kosova Cumhuriyeti vatandaşları başvuru hakkına sahiptir. 07/2017 Sayılı İdari Yönergeye (MLSW) dayanarak, bu yarışmaya göre uygun eğitimi tamamlamış ve görevlerini yerine getirebilecek profesyonel kabiliyete sahiptir.
Rekabet Prosedürleri:
Yarışma, bu pozisyonla ilgilenen tüm adaylara açıktır.
Yarışma, medyada yayınlandığı günden 15 gün sonra duyurulur.
• Taleplerin Gönderilmesi: Kişilerarası iyi ilişkiler kurma becerisine sahip olmak;
Başvurular Personel Sektörü ofisine teslim edilir ve teslim edilir. Başvuru, iş unvanını ve referans numarasını açıkça belirtmelidir.
Yarışmanın bitiş tarihinden sonra gönderilen başvurular ve bitmemiş talepler kabul edilmeyecektir.
Boşluk duyurusu altında kanıt sağlamak için başvuran adaylar, aksi takdirde yarışma koşullarını karşılamayan adaylar mülakata alınmayacaktır.
Yarışmanın şartlarını uygulayan ve karşılayan herhangi bir aday 100 puan yazılı teste tabi tutulacaktır. Testin% 50'sinden geçen Knaddates, sözlü mülakata çağrılma hakkını kazanıyor.

Idare muduru

Ma.Scc. Melinda Çollaku

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Prizren

Nr.. 8/10
Më: 08.03.2019
P r i z r e n
Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ (MPMS)Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Nenit 62, pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Kërkesës nr. 2/7 e datës 14.01.2019 dhe aprovimit nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së me datën 18.01.2019, si dhe nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

KONKURS
Dëshiron të pranojë në punë në kohë të pacaktuar

Pozita: Zyrtar ligjor (1 pozitë)
Koeficienti i pagës: (7.2)
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Drejtorit të Administratës
Nr. i Referencës: 8/10, date: 08.03.2019

Qëllimi kryesor i vendit të punës për Zyrtar Ligjor
Të jetë përgjegjes dhe efikas në ofrimin e shërbimit të punëve juridike. Të ofrojë mbështetje ligjore në hartimin e akteve juridike dhe administrative nga fushëveprimi i spitalit. Të ofrojë rekomandime dhe këshilla ligjore për punonjësit e spitalit, sipas kërkesës.
Detyrat dhe Përgjegjësit :
- Identifikimi i ligjeve pozitive dhe zbatimin e tyre
- Hartimin e vendimeve, propozimeve dhe të akteve të ndryshme të kërkuara nga shefi i zyrës dhe drejtori i Administratës
- Siguron komunikimin dhe pranimin e palëve sipas rasteve dhe nevojave të palëve
- Ofron shërbime gjithë stafit të spitalit lidhur me çështjet ligjore –juridike përmes sigurimit të këshillave të duhura rreth aspekteve juridike
- Krynë shërbime juridike dhe shërbime tjera për nevoja të spitalit
- Pranon thirrjet , aktgjykimet dhe shkresat e ndryshme nga gjykata , përgatit shkresat për gjykatë si përgjigjet në padi , ankesat dhe veprimet tjera procedural dhe pas përfundimit të lëndësi ruan ato në kartotekë të veçantë.
- Përfaqëson spitalin në konteste të ndryshme në gjykatë sipas autorizimit
- Bashkërendon dhe ndërlidhë punët sipas nevojës me zyrtarët e tjerëligjor të zyrës
- Përpilon raporte të rregullta pune

Kualifikimi :
- Shkollim Universitar , Drejtimi Juridk

Njohuria , shkathësitë,aftësitë,kualifikimi i kërkuar :
- Diplomë e Fakultetit Juridik ;
- Njohja e mirë e legjislacionit relevant në lëmin e shëndetësise dhe shërbimit publik te Kosovës;
- Njohja e punës me kompjuter në program (Word-Exel);
- Të ketë shkathësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale ;
- Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
- Aftësi për të punuar me mbikëqyrje ;
- Shkathësi në komunikim dhe negocim ;
- Certifikatën e lindjes;
- Letërnjoftimi , fotokopje .

Kushtet e kërkuara :
Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet
Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara te noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.
Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar . bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr .07/2017 kanë mbaruar shollimin e duhur sipas këtij konkursi dhe kanë aftësine profesionale për kryerjen e detyrave .
Procedurat e Konkurimit :
Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatëte interesuar për këtë pozitë.
Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit
Paraqitja e Kërkesave :
Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit . Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.
Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen .
Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë deshmi sipas konkursit të shpallur , për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojne kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.
Çdo kandidate që aplikon dhe i plotëson kushtet sipas konkusit do t'i nënshtrohet testit me shkrim prej 100 poenëve . Knadidatët të cilët kalojnë 50 % të testit , fitojnë të drejtën të thirren për intervistim me gojë.

Drejtoresha e Administratës
Ma. Sc. Melinda Çollaku

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Prizren

Br.: 8/10
Dana: 08.03.2019
P r i z r e n
Na osnovu člana 8 Zakona br. 03 / L-212 o radu, Administrativno uputstvo (MRSZ) Br. 07/2017 O regulisanju postupka javnog konkursa, član 62, tačka 6 Zakona br. 04 / L-125 o zdravlju, Zahteva br. 2/7 datum: 14.01.2019 i dozvoljenja od generalnog direktora SHSKUK-a, datum: 18.01.2019 Godine, kao i član 13, tačka 1.1 Statuta bolnice, Upravni odbor Opšte bolnice objavljuje:

OGLAS
Želi da prima na posao na neodređeno vreme

Pozicija: pravni službenik (1 pozicija)
Koeficijent rada: (7.2)
Radnio vreme: puni raspored (40 sati nedeljno)
Ugovor: Prema važećem zakonodavstvu
Izvještaj: Direktor uprave
Br. Referenca: 8/10, datum: 08.03.2019

Glavna svrha posla za pravnog službenika:
Biti odgovoran i efikasan u pružanju pravnih usluga. Pružiti pravnu podršku u izradi pravnih i administrativnih akata iz djelokruga bolnice. Dati preporuke i pravne savjete bolničkom osoblju na zahtjev.
Dužnosti i odgovornosti:
